

**VENDIM**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Hajredin Fuga,   | Anëtar i “ “                   |
| Bardha Selenica, | Anëtar i “ “                   |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i “ “                   |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i “ “                   |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i “ “                   |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i “ “                   |

Me sekretare Drita Filto, më datë 04.02.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.5 Akti që i përket :

**K Ë R K U E S:** PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**O B J E K T I:** Interpretimi i nenit 179 pika 1 dhe nenit 127, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

Në kërkesë si shkak parashtrohet se:

Del e nevojshme të interpretohet nëse neni 179 pika 1 i Kushtetutës do të zbatohet apo jo për institucionet që kanë fituar mandatet me Ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, por që vetë Kushtetuta e ndërpret këtë mandat me vërtetimin e njërës prej shkaqeve të përmendura në të, siç është rasti i parashikuar në nenin 127, pika 1, gërma “c”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të sigurohej vazhdimësia në veprimtarinë e organeve kushtetuese në nenin 179, pika 1, ka parashikuar se: “Mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute, mbaron me afatet e parashikuara në Ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 127, si shkak për mbarimin para afatit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ka parashikuar edhe mbushjen e moshës 70 vjeç (pika 1 gërma “c”), shkak i cili nuk parashikohej në nenin 23 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04. 1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Kërkesa në thelb, ka të bëjë me faktin nëse ky shkak i ri i mbarimit të mandatit para afatit, do të zbatohet për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë fituar mandatin sipas Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992, apo për ata, do të pranohen vetëm rastet e mbarimit të mandatit të parashikuara nga ky ligj.

Nga shqyrtimi i nenit 179, pika 1 të Kushtetutës, në raport me nenin 127, pika 1, shkronja “c”, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se Ligji nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse do të zbatohet për anëtarët që kanë fituar mandatet me këtë ligj, por vetëm për ata që i përket afatit të zakonshëm kohor të ushtrimit të tij, i cili në bazë të nenit 18, të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 ka qenë 9 (nëntë) vjet për anëtarët e caktuar në zgjedhjen e parë dhe 12 (dymbëdhjetë) vjet, për anëtarët zëvendësues.

Për rastet e ndërprerjes së mandatit para kohe (duke përfshirë dhe ndërprerjen e mandatit me mbushjen e moshës 70 vjeç), ashtu si dhe për elemente të tjerë thelbësore të tij, edhe këta anëtarë, do t’i nënshtrohen dispozitave të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

Sipas nenit 179, pika 1 e Kushtetutës, Ligji nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet e plotësimet përkatëse, do të zbatohet për organet që kanë fituar mandatin sipas këtij ligji, vetëm përsa i përket afatit kohor të zakonshëm të ushtrimit të tij dhe jo edhe për shkaqet e mbarimit të parakohshëm, siç është edhe plotësimi i moshës 70 vjeç, parashikuar nga neni 127, pika 1, shkronja “c” e Kushtetutës, për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi nga dita e hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Tiranë, më 03.03.2000

Nr.5 i Regj.Themeltar.

Nr.8 i Vendimit.